



UNIVERSITETI I GJAKOVËS
"FEHMI AGANI"
UNIVERSITY OF GJAKOVA

Rr. Ismail Qemali, pn 50 000 GJAKOVË, Republika e Kosovës
Tel: 038 200 20 831; www.uni-gjk.org

Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc.Dr. Mazllom Kumnova

Nr. Prot.: 05/1104
Datë 29/07/2019

Këshilli Drejtues i Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", bazuar në kompetencat sipas neneve 17, 22 dhe 23 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit dhe në Udhëzimin Administrativ Nr.24/2012 Kategoritë e studentëve për asistencë si dhe kushtet për fitimin e asistencës dhe në Udhëzimin Administrativ Nr.17/2014 Aplikimi i pagesave të studentëve në Universitetet publike, në mbledhjen e mbajtur më 29.07.2019, mori këtë:

V E N D I M

I . Të shpallet njoftimi për lirim nga pagesa të studentëve të UGJFA-së për vitin akademik 2018/2019, sipas kategorive në vijim:

1. Studentët, familjet e të cilëve janë në asistencë sociale si dhe studentët familjet e të cilëve nuk kanë asnjë burim të të ardhurave;
2. Studentët të cilët janë invalidë ose veteran të luftës dhe fëmijët e tyre;
3. Studentët që kanë mbetur pa njërin prind si pasojë e luftës (në kohën prej 01.01.1998 – 12.06.1999);
4. Studentët me nevoja të veçanta;
5. Familjet kosovare që kanë më tepër se një student në universitetet publike të Kosovës do të paguajnë vetëm për një student, ndërsa për studentët tjerët nuk do të paguajnë.

II. Në njoftim do të paraqitet afati i aplikimit, dokumentacioni i nevojshëm për aplikim dhe kushtet tjera.

III. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Vendimi t'i dërgohet:

Arkivit të UGJFA-së;
Njësive akademike;
Zyrës së financave;
Zyrës ligjore.



Kryesuesi i Këshillit Drejtues

Prof. Asoc. Dr. Mazllom Kumnova